



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Qendra Kërkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe Ekonomi në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për **1 (një)** pozicion pune personel akademik, me kohë të plotë **lektor** dhe **4 (katër)** personel akademik në pozicionin e punës **asistent lektor**.

Kriteret për pozicionin e punës **lektor**.

Kandidati duhet të zotërojë këto kritere të përgjithshme:

1. Të mbajë gradën shkencore Doktor i Shkencave në Drejtësi me profil në një nga fushat e studimit: E Drejtë Biznesi; e Drejtë Tatimore; e Drejtë Financiare.
(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Kandidati duhet të ketë të paktën 2 (dy) vjet përvojë punë në IAL.
3. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të zotërojë këto kritere të veçanta.

1. Të ketë përvojë punë me projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
2. Të ketë përvojë pune me projekte në sektorin publik/OJF/Organizma Ndërkombëtare (përbën avantazh pjesëmarrja në shkrimin, hartimin dhe zbatimin e projekteve);
3. Të ketë përvojë në mësimdhënie të paktën një vit si titullar lënde;
4. Të ketë përvojë në zhvillimin e trajnimeve;
5. Të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore dhe publikim artikujsh shkencorë në revista shkencore ose Proceedings Books.

Kritere për pozicionet e punës **asistent lektor**

Kandidati duhet të zotërojë këto kritere të përgjithshme:

1. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të në një nga fushat: Shkencave Sociale; Shkencave Politike; Shkencave Humane. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

2. Të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të në fushat e mësipërme me notë mesatare mbi 8. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3. Të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian.
4. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të largimit nga puna.
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kandidati duhet të zotërojë këto kritere të veçanta.

1. Të ketë përvojë pune me projekte në sektorin publik/OJF/Organizma Ndërkombëtare (përbën avantazh pjesëmarrja në shkrimin, hartimin dhe zbatimin e projekteve);
2. Të ketë përvojë pune në IAL të paktën 1 (një) vit;
3. Të ketë përvojë punë me projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
4. Përvojë në zhvillimin e trajnimeve;
5. Pjesëmarrja në konferenca shkencore dhe publikim të artikujve shkencorë të botuar në revista shkencore ose Proceedings Books.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**26.10.2020– 04.11.2020**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Formular aplikimi;
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Kopje e noterizuar e diplomave dhe të listave të notave. (Diplomat e lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- Dokumentacion shoqëruar përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kritereve të shpalluara;
- Fotokopje e njësuar e librezës së punës/Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti);
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Fotokopje e letërnjoftimit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (26.10.2020– 04.11.2020) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës:
Fakulteti Ekonomik
Personel me kohë të plotë QKZHDE
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Fakultetit Ekonomik**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit si dhe për orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.

Shënim: *Formularët për plotësim gjenden në adresën:*

www.uniel.edu.al/fakulteti_ekonomik